

PHILIPS

Kufje për fëmijë

Seria 4000

TAK4607



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Udhëzime të rëndësishme sigurie	2
	Siguria për dëgjimin	2
	Informacione të përgjithshme	2
<hr/>		
2	Kufjet tuaja me Bluetooth	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Pajisjet e tjera	3
	Përmbledhje për kufjet tuaja me Bluetooth	4
<hr/>		
3	Fillimi	5
	Karikimi i baterisë	5
	Çiftimi i kufjeve me telefonin celular	5
<hr/>		
4	Përdorimi i kufjeve	6
	Lidhja e kufjeve me pajisjen me Bluetooth	6
	Kontrollimi i telefonatave dhe muzikës	6
	Limiti i kohës së luajtjes dhe limiti i volumit mund të vendoset në aplikacionin Philips Headphones	7
<hr/>		
5	Të dhëna teknike	9
<hr/>		
6	Njoftim	10
	Deklarata e konformitetit	10
	Hedhja e produktit dhe baterisë së vjetër	10
	Heqja e baterisë së brendshme	10
	Pajtueshmëria me EMF	10
	Informacione mjedisore	11
	Njoftim për pajtueshmërinë	11
<hr/>		
7	Markat tregtare	12
<hr/>		
8	Pyetje të bëra shpesh	13

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Siguria për dëgjimin



Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin në dëgjim, kufizoni kohën që e përdorni kufjet me vullm të lartë dhe vendoseni vullmin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë vullmi, aq më e shkurtër është koha e dëgjimit.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur e përdorni kufjet.

- Dëgjoni në volume të arsyeshme për periudhave kohore të arsyeshme.
- të mos rregulloni vazhdimisht vullmin lart pasi të dëgjuarit tuaj përshtatet.
- Mos e ngrini vullmin kaq shumë sa që të mos dëgjoni dot çfarë ndodh rreth jush.
- Ju duhet të përdorni kujdes ose të ndërpritni përkohësisht përdorimin në situatave të mundshme të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i tingullit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.
- Përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar gjatë drejtimit të automjetit nuk rekomandohet dhe mund të jetë i jashtëligjshëm në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrimet nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik ose në mjedise të mundshme të rrezikshme.

Informacione të përgjithshme

Për të shmangur dëmtimin ose keqfunksionimin:



Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet në nxehtësi ekstreme.
- Mos i rrëzoni kufjet.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj spërkatjeve ose lëngjeve. (Shikoni vlerësimin IP të produktit specifik)
- Mos lejoni që kufjet të zhyten në ujë.
- Mos i karikoni kufjet kur konektori ose priza është e lagur.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, , benzinë, ose gërryes,
- Nëse nevojitet pastrim përdorni një leckë të butë, nëse është e nevojshme me një sasi të ulët uji ose sapun të butë të shkrirë, për të pastruar produktin.
- Bateria e integruar nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt siç është drita e diellit. zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Për të arritur vlerësimin IP të caktuar, kapaku i vendit të karikimit nuk duhet të mbyllet.
- Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë, ose shtypja apo prerja mekanikisht e baterisë mund të shkaktojë shpërthim.
- Lënia e baterisë në ambient me temperaturë tepër të lartë mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të djegshëm.
- Në rast se bateria lihet në presion atmosferik tepër të ulët, kjo mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të djegshëm.

Temperatura dhe lagështia për ruajtjen


- Mbajeni në një vend ku temperatura është në temperaturë ndërmjet -20 °C dhe 50 °C me lagështi relative deri në 90%.
- Përdoreni në një end ku temperatura është ndërmjet 0 °C dhe 45 °C me lagështi relative deri në 90%.
- Jetëgjatësia e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte temperature të lartë ose të ulët.
- Nëse bateria ndërrohet me një tip baterie të gabuar, kjo rrezikon të dëmtojë kufjet dhe baterinë (për shembull, në rastin e disa llojeve të baterive të litiumit).

2 Kufjet tuaja me Bluetooth

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/support. Me këto kufje me valë ju mund të:

- bëni me lehtësi telefonata pa duar nëpërmjet valëve
- dëgjoni dhe kontrolloni muzikën nëpërmjet valëve
- kaloni mes telefonatave dhe muzikës


Çfarë ka në kuti



Kufje me valë për fëmijë Philips TAK4607




Tapa për veshët x 1 palë



Çantë e butë



Kablllo karikimi Type-C
(vetëm për karikim)



Manuali i përdorimit



Garancia botërore






Fletëpalosja për sigurinë

Pajisjet e tjera

Një celular ose një pajisje (p.sh. një laptop, tabletë, adaptorë me Bluetooth, aparate MP3 etj) e cila mbështet Bluetooth dhe është e pajtueshme me kufjet (shiko "Të dhëna teknike" në faqen 9).

Përmbledhje për kufjet tuaja me Bluetooth



- ① Drita LED
- ② Vendi i karikimit Type C
- ③ Volumi -
- ④  Butoni i energjisë / Volumi +
- ⑤ Butoni multi-funksional (MFB)

3 Fillimi

Karikimi i baterisë

Shënim

- Para se t'i përdorni kufjet, vendosini në kutinë e karikimit dhe karikoni baterinë për dy orë për të pasur kapacitet dhe jetëgjatësi optimale të baterisë.
- Përdorni vetëm kablo karikimi USB origjinale për të shmangur dëmtimet.
- Mbaroni telefonatën para se t'i karikoni. Lidhja e kufjeve për t'i karikuar do t'i fikë ato.

Lidheni kabllon e karikimit Type-C me:


- Portën e karikimit Type-C në kufje dhe;
 - Karikuesin/portën USB të një kompjuteri.
- ↳ Drita LED ndizet ngjyrë blu dhe fiket kur kufjet janë të karikuara plotësisht.

Këshillë

- Normalisht, karikimi i plotë zgjat 2 orë.

Çiftimi i kufjeve me telefonin celular

Para se t'i përdorni kufjet me telefonin celular për herë të parë, çiftojini me një telefonin celular. Një çiftim i suksesshëm bën të mundur një lidhje unike të enkriptuar mes kufjeve dhe telefonit celular. Kufjet ruajnë në memorie 4 pajisjet e fundit. Nëse mundoheni të çiftoni më shumë se 4 pajisje, pajisja e çiftuar e para zëvendësohet me atë më të fundit.

- 1 Sigurohuni që kufjet janë karikuar plotësisht dhe janë të fikura.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur  për 4 sekonda derisa drita LED blu të pulsojë shpejt.
↳ Kufjet qëndrojnë në modalitetin e çiftimit për 5 minuta.
- 3 Sigurohuni që telefoni celular është i ndezur dhe që Bluetooth është i aktivizuar.
- 4 Çiftoni kufjet me telefonin celular. Për informacione të detajuara, referojuni manualit të përdorimit të telefonit tuaj celular.

Shembulli i mëposhtëm tregon se si t'i çiftoni kufjet me telefonin celular.

- 1 Aktivizoni veçorinë Bluetooth të celularit tuaj, zgjidhni **Philips TAK4607**.
- 2 Formoni 'fjalëkalimin e kufjeve "0000" (katër zero) nëse kërkohet. Për ato pajisje që kanë Bluetooth 3.0 ose më të lartë, nuk ka nevojë të vendoset fjalëkalim.



Philips TAK4607

4 Përdorimi i kufjeve

Lidhja e kufjeve me pajisjen me Bluetooth

- 1 Ndizeni celularin/pajisjen me Bluetooth.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin e ndezjes/fikjes për t'i ndezur kufjet.
 - ↳ Drita LED blu ndizet 1 sekondë.
 - ↳ Kufjet lidhen përsëri automatikisht me telefonin celular/pajisjen Bluetooth që ishte lidhur për herë të fundit. Nëse pajisja e fundit nuk është e disponueshme, kufjet do të jenë në modalitetin e çiftimit



Këshillë

- Nëse e ndizeni telefonin celular/pajisjen me Bluetooth ose aktivizoni Bluetooth pasi keni ndezur kufjet, duhet t'i lidhni përsëri manualisht kufjet dhe telefonin celular/pajisjen me Bluetooth.



Shënim

- Nëse kufjet nuk lidhen me asnjë pajisje Bluetooth për 5 minuta, ato do të fiken automatikisht për të kursyer baterinë.

Kontrollimi i telefonatave dhe muzikës

Ndezur/fikur

Detyra	Butoni	Punimi
Ndizeni kufjet	Butoni i energjisë	Mbajeni shtypur për 2 sekonda
Fikini kufjet	Butoni i energjisë	Mbajeni shtypur për 4 sekonda ↳ Drita LED blu ndizet 1 sekondë

Kontrolli i muzikës

Detyra	Butoni	Punimi
Luani ose ndaloni muzikën	MFB	Shtypeni një herë
Rregullimi i volumit	+/-	Shtypeni një herë
Kënga tjetër	+	Shtypje e gjatë
Kënga e mëparshme	-	Shtypje e gjatë

Kontrolli i telefonatave

Detyra	Butoni	Punimi
Përgjigja/mbylja e një telefonate	MFB	Shtypeni një herë
Refuzoni një telefonatë	MFB	Shtypje e gjatë
Kaloni te telefonuesi tjetër gjatë një telefonate	MFB	Shtypeni dy herë

Statusi i treguesit të kufjes tjetër

Statusi i kufjeve	Treguesi
Kufjet janë të lidhura me një pajisje Bluetooth, ndërsa kufjet janë në gjendje pritjeje ose ndërsa dëgjoni muzikë.	Drita LED blu pulson çdo 4 sekonda
Kufjet janë gati për çiftim	Drita LED pulson shpejt ngjyrë blu
Kufjet janë të ndezura por nuk janë të lidhura me një pajisje me Bluetooth	Drita LED pulson dy herë çdo 3 sekonda. Nëse nuk mund të bëhet asnjë lidhje, kufjet fiken vetë brenda 5 minutash
Nivel i ulët i baterisë	Drita LED blu pulson 3 herë çdo minutë derisa t'i mbarojë energjia
Bateria është karikuar plotësisht	Drita LED blu është e fikur

Limiti i kohës së luajtjes dhe limiti i volumit mund të vendoset në aplikacionin Philips Headphones

Skanooni kodin QR/shtypni butonin "Shkarko" ose kërkoni "Philips Headphones" në Apple App Store ose Google Play për të shkarkuar aplikacionin.








Limiti i kohës së luajtjes:

- Në aplikacionin Philips Headphones mund të përcaktohet koha e luajtjes.
 - ↳ Sigurohuni që pajisja është e lidhur me kufjet dhe vendosni kohën e luajtjes në aplikacionin Philips Headphones.
- Do të dëgjohet një zë që thotë "Playtime limit enabled" (Limiti i luajtjes i aktivizuar) 10 minuta para se volumi të arrijë limitin e caktuar paraprakisht.
 - ↳ a) Kur arrihet limiti i kohës së luajtjes, dëgjohet zëri që thotë "Playtime limit enabled" dhe muzika në kufje do të ndalohej. Zëri "Playtime limit enabled" do të luhet çdo 10 sekonda derisa të mbarojë bateria. Pajisja e çiftuar me kufjet do të ndalohej njëkohësisht;
 - b) Nëse doni të vazhdoni luajtjen nga pajisja e lidhur, ju lutemi t'i fikni kufjet për t'i shkëputur nga pajisja.
- Ndizini përsëri brenda të njëjtës dite:
 - ↳ 1. Nëse nuk është arritur koha e luajtjes në sesionin e mëparshëm, koha e luajtjes vazhdon të llogaritet nga sesioni i mëparshëm dhe ndiqet përshkrimi që tregohet te pika a).
 - 2. Nëse nuk është arritur koha e luajtjes në sesionin e mëparshëm, ndiqet përshkrimi që tregohet në pikën a).
 - 3. Nëse doni të rivendosni limitin e kohës së luajtjes, ju lutem zgjidhni "asnjëherë" te pjesa e limitit të kohës së luajtjes në aplikacionin Philips Headphones.
- Ditën tjetër, kohëmatësi i limitit të kohës së luajtjes do të rivendoset dhe llogaritet nga "0"min.

Limiti i volumnit:

- Në aplikacionin Philips Headphones mund të vendoset limiti i volumnit:
 - ↳ a) Sigurohuni që pajisja është e lidhur me kufjet dhe vendosni limitin e volumnit në aplikacionin Philips Headphones.
- Aktivizohet zëri "Volume limit enabled" (Limiti i volumnit i aktivizuar) kur volumni i kufjeve është më i lartë se volumni i përcaktuar në aplikacionin Philips Headphones.
 1. Nëse volumni i kufjeve është më i lartë se limiti i volumnit i përcaktuar në aplikacion, volumni i kufjeve do të ulët çdo 1 minutë me një zë që thotë "Volume limit enabled" derisa të arrihet volumni i përcaktuar.
 2. Nëse volumni i kufjeve është i njëjtë ose më i ulët se volumni i përcaktuar në aplikacion, volumni nuk do të ndryshojë.
- Kur kufjet fiken dhe ndizen përsëri, limiti i volumnit do të fshihet.
- Ditën tjetër, kohëmatësi do të fshihet. Për ta aktivizuar përsëri, vendosni limitin e volumnit.



Shënim

1. Ju lutemi ta mbani aplikacionin Philips Headphones në pajisjen e prindërve për t'u siguruar që të mos ndryshohen cilësimet.
2. Nëse nuk dëgjoni asgjë kur i përdorni kufjet, kontrolloni nëse është aktivizuar limiti i kohës së luajtjes.
3. Limiti i kohës së luajtjes mund të fshihet duke shtypur njëkohësisht butonat "volumi +" dhe "volumi -" për 5 sekonda. Kjo do t'i rikthejë kufjet në parametrat e fabrikës.

5 Të dhëna teknike

- Koha e muzikës: 5 orë
- Koha e bisedës: 4 orë
- Koha në gjendje pritjeje: 80 orë
- Koha e karikimit: 2 orë
- Bateri e karikueshme me polimere litiumi (200 mAh)
- Versioni i Bluetooth: 5,2
- Profilët e pajtueshme të Bluetooth:
 - HFP (Hands-Free Profile)
 - A2DP (Advanced Audio Distribution Profile)
 - AVRCP (Audio Video Remote Control Profile)
- Audio-codecs që mbështeten: SBC
- Rrezja e frekuencave: 2.402-2.480 GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 10 dBm
- Distanca e punimit: Deri në 10 metra
- 1 mikrofon për anulimin e zhurmës mjedisore
- Fikja automatike
- Portë USB-C për karikim
- Paralajmërim për bateri të ulët: e disponueshme
- IPX5



Shënim

- Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

6 Njoftim

Deklarata e konformitetit

MMD Hong Kong Holding Limited deklaron këtu se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të RED Directive 2014/53/EU dhe UK Radio Equipment Regulations SI 2017 No 1206. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.

Hedhja e produktit dhe baterisë së vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga European Directive 2012/19/EU.




Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të karikueshme të brendshme që mbulohet nga European Directive 2013/56/EU e cila nuk mund të hidhet së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Ju këshillojmë fort që ta çoni produktin te një pikë grumbullimi zyrtare ose në një qendër servisi të Philips në mënyrë që një profesionist ta heqë baterinë e karikueshme. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive të karikueshme. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë e vjetra bashkë me mbetjet e zakonshme. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe baterive të karikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterisë së brendshme

Nëse në vendin tuaj nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produktet elektronike, mund ta mbronni mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë para se t'i hidhni kufjet.

- Sigurohuni që kufjet të jenë të shkëputura para se të hiqni baterinë.



Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt i përmbahet të gjitha standardeve dhe rregullave lidhur me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistirol (amortizuesi) dhe polietilien (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri). Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Njoftim për pajtueshmërinë

Pajisja është në përputhje me rregullat FCC, Pjesa 15. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar.

Rregullat FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Kategorisë B, sipas pjesës 15 të rregullave FCC. Këto limite janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient banimi. Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas manualit të udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio.

Megjithatë, nuk ka garanci se nuk do të ketë interferenca në një ambient të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe nderuar pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiket ta korrigjojë interferencën duke ndjekur

një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose zhvendosni antenën
- Rritni hapësirën mes pajisjes dhe marrësit
- Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi
- Konsultoni me shitësin ose me një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë

Deklarata e ekspozimit të rrezatimit FCC:

Kjo pajisje përputhet me kufijtë FCC e ekspozimit ndaj rrezatimit të Kanadasë të përcaktuar për mjediset e pakontrolluara. Transmetuesi nuk duhet të ndodhet në të njëjtin vend me ndonjë antenë ose transmetues tjetër apo të punojë bashkë me to.

Kujdes: Përdoruesi paralajmërohet se ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për të përdorur pajisjen.

Kanada:

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe (2) kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë operim të padëshiruar të pajisjes. CAN ICES-003(B)/NMB-003(B)

Deklarata e ekspozimit të rrezatimit IC:

Kjo pajisje është në përputhje me limitet e Kanadasë për ekspozimin ndaj rrezatimit që janë përcaktuar për mjediset e pakontrolluara. Transmetuesi nuk duhet të ndodhet në të njëjtin vend me ndonjë antenë ose transmetues tjetër apo të punojë bashkë me to.

7 Markat tregtare

Bluetooth

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë.

Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.

Siri

Siri është një markë tregtare e Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe në shtete të tjera.

8 Pyetje të bëra shpesh

Kufjet e mia me Bluetooth nuk ndizen.

Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni kufjet.

Nuk i çiftoj dot Kufje e mia me Bluetooth me pajisjen time me Bluetooth.

Bluetooth është çaktivizuar. Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth dhe ndizeni pajisjen me Bluetooth para se të ndizni kufjet.

Pajisja me Bluetooth nuk i gjen dot kufjet.

- Kufjet mund të jenë lidhur me një pajisje të çiftuar më parë. Fikeni pajisjen e lidhur ose largojeni jashtë rrezes.
- Çiftimi mund të jetë fshirë ose Kufje janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftojini përsëri kufjet me pajisjen me Bluetooth siç tregohet në manual. (shikoni "Çiftimi i kufjeve me telefonin celular" në faqen 5).

Kufjet e mia me Bluetooth janë lidhur me një telefon celular me Bluetooth stereo, por muzika luhet vetëm në boksën e celularit tim.

Shikoni manualin e përdorimit të celularit tuaj. Zgjidhni të dëgjoni muzikë përmes kufjeve.

Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohet zhurmë kërcitjeje.

- Pajisja Bluetooth është jashtë rrezes. Afroni kufjet dhe pajisjen Bluetooth, ose largoni pengesat mes tyre.
- Karikoni kufjet.

Cilësia e audios është e dobët kur përcillni audio nga një celular, është shumë e ngadaltë ose streaming nuk funksionon fare.

Sigurohuni që telefoni celular mbështet jo vetëm (mono) HFP, por mbështet edhe A2DP dhe është i pajtueshëm me BT4.0x (ose më i lartë) (shiko "Të dhëna teknike" në faqen 9).

Dëgjoj por nuk mund ta kontrolloj muzikën në pajisjen time Bluetooth (p.sh. luaj/pauzë/kapërce përpara/mbrapa).

Sigurohuni që burimi audio Bluetooth mbështet AVRCP (shiko "Të dhëna teknike" në faqen 9).

Niveli i volumit të kufjeve është shumë i ulët.

Disa pajisje me Bluetooth nuk e lidhin dot nivelin e volumit me kufjet me anë të sinkronizimit të volumit. Në rast të tillë, duhet të rregulloni veçmas volumin në pajisjen me Bluetooth për ta çuar volumin në nivel të përshtatshëm.

Nuk i lidh dot kufjet me një pajisje tjetër. Çfarë të bëj?

- Sigurohuni që Bluetooth në pajisjen e çiftuar më parë është çaktivizuar.
- Përsëritni procedurën e çiftimit në pajisjen e dytë (shiko "Çiftimi i kufjeve me pajisjen me Bluetooth për herë të parë" në faqen 5).

Për më shumë ndihmë, vizitoni www.philips.com/support



2022©MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt. Të gjithë emrat e tjerë të kompanive dhe produkteve mund të jenë marka tregtare të kompanive përkatëse.

UM_TAK4607_00_SQ_V2.0

Modeli: TAK4607LX

